



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr _____ Prot.

Gramsh më ____/____/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje dru zjarri dhe pelet per vitin 2025”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Dru zjarri
03413000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 8 554 757 (tetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Gramsh ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

.....
I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 82 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic

është parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "*Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej në Procedurën e Hapur e thjeshtuar, perkatesisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar*; Duke qene se kjo procedure prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "*Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat"* i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore të ardhurave;

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**"

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*" i ndryshuar.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **e maturuar** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së. **Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Argumentimi: Njësia e prokurimit gjykon se bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të deklaruara në organet tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 4, neni 55, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi

dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2. Operatori ekonomik /ofertuesi duhet të paraqesi Liçensën profesionale të Shoqërise duke dëshmuar që zotëron këto kategori lidhur me zotërimin e punëve të kontratës:

kodi III.2.B "Sharrim,grumbullim dhe përpunim i lëndës drusore" lëshuar nga QKL.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 41, pika 4, gërma (a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e shqipërisë, si dhe në VKM-në Nr.538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet OKL dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta "E ndryshuar, për licencat e grupit të trete;

2.3.3 Mjetet dhe pajisjet teknike që duhet të disponoj operatori ekonomik ofertues:

Lloji i makinerive/mjeteve	Sasia	Gjendja
Kamion transporti kapaciteti mbajtës minimum 15 (pesëmbëdhjetë) ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Kamion me vinç kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Kamionçinë	2 copë	Pronësi ose me qira
Motosharrë	3 copë	Pronësi ose me qira
Sharrë për prerjen e druve	1 copë	Pronësi ose me qira
Makineri për çarjen e druve	1 copë	Pronësi ose me qira

Të gjitha mjetet e lartpërmendura duhet të shoqërohen me fotot përkatëse,duhet të jenë në pronësi ose me qira dhe ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

a- Aktin e pronësisë së mjetit përkatës ;

ose

b- Kontratën e marjes me qira të mjetit shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë duhet të jetë noteriale e të jetë e vlefshme për gjithë afatin e marrëveshjes kuadër.

- *Për mjetet në pronësi ose me qira që shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, e vlefshme.*
Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes, duhet të paraqitet akti i pronësisë së mjetit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ç, dhe pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar një numër prej mesatarisht 7(shtatë) personave, për datën e hapjes së tenderit .

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojces nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve .
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për, datën e hapjes së tenderit ,shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Argumentimi: Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për realizimin e kontratës në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 40, pika 5, gërma "c".

Sqarojmë se, numri i punonjësve ishte përcaktuar referuar volumeve të druve shpërndarjes së tyre në institucione të ndryshme arsimore në qytet dhe Njësitë Administrative , afatit të realizimit të kontrates objekt prokurimi, me qëllim realizimin me sukses dhe në kohë të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Gramsh nr.213, datë 30.06.2025, "Për ngritjen e komisionit për përcaktimin e sasive, vlerësimin dhe përlogaritjen fondit limit dhe specifikimet teknike për funizimin me dru zjarri dhe pellet të çerdheve, kopshteve, shkollave, konviktit të shkollës së mesme për vitin shkollor 2025 - 2026, si dhe zyrat e Njësive Administrative".

Përshkrim dhe specifikime (kërkesa) teknike për dru zjarri :

1. Lloji i druve të zjarrit: Lloji ah, mare, mbrete
2. Gjatësia e druve të prera , të jetë 30 – 35 cm . Në rast të kundërt , për mosplotësim të këtij kushti, do të bëhet korrektimi i volimit sipas gjatësisë faktike
3. Diametri (trashësia), mbi 4 cm në pjesën e hollë, e ndarë si më poshtë :
 - a. Me diametër 4 – 10 cm, të rrumbullakëta dhe të paçara, jo më shumë se 10 % e sasisë.
 - b. Me diameter mbi 10 cm, të jetë 90 % e sasisë ose e gjithë sasia e kontaktuar . Drutë e zjarrit të jenë të çara në funksion të diametrit që kanë, me qëllim që të jenë të manovrueshme gjatë futjes në sobën e zjarrit (stufë).
4. Drutë mund të jenë të përziera (të njoma + të thata). Nuk pranohen dru të kalbura apo dru jashtë kriterëve të përcaktuara, nëse rezultojnë, do të zbriten nga sasia totale .
5. Drutë e zjarrit, nuk duhet të jenë të bigëzuara, dhe ne rast se ka të tilla, gjatësia e degëve të prera nga trupi, nuk duhet të jetë mbi 5 cm.
6. Kontraktori, ka për detyrë të transportojë, shkarkojë dhe stivosë në destinacion drutë e zjarrit, sipas orientimit të strukturës përgjegjëse që merr në dorëzim drutë.

7. Mjetet dhe punëtorët do të sigurohen nga vetë subjekti i furnizimit me dru zjarri .
8. Drutë e zjarrit të pa prera të sistemohen në stivë me përmasa: lartësi 1 m x 1 m gjatësi, dhe më pas bëhet matja dhe marrja në dorëzim e tyre
9. Matja e sasisë së furnizimit me dru të prera, do të bëhet me kubikë 1 x 1 x 0.7 m.
10. Materiali drusor,dorëzohet ne çerdhe, kopshte, shkolla, konvikt dhe Nj. Administrative , sipas planshpërndarjes,
brenda datës 15. 11. 2025

Specifikime teknike për peletin :

- Pelleti, të jetë i ambalazhuar në thasë (qeska) ku shënohet dhe pesha ; Përbërja, dru i ngjeshur; Diametri, 6 – 8 mm; Gjatësia, 10- 30 mm; Lagështia, deri ne 10 %; Dendësia, 650 – 750 kg / m³ ; Përbërja e hirit, deri në 2 %; Vlera kalorifike (energjia e lëshuar), 4600-5000 kWh / ton ; Ngjyra, druri pak e erret; Sipërfaqja, e lëmuar (jo shumë e thyer)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni i ngritur me me Urdhërin e Zyrtarit te Autorizuar N/Kryetarit të Bashkisë nr.213, datë 30.06.2025 Ngritjen e Komisionit për përcaktimin e sasive, hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e Fondit Limit për objektin e prokurimit “Blerje dru zjarri dhe pelet per vitin 2025”.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

Njësia e Prokurimit:

Roland Mimini

Erionilda Miraka

Loina Zogu

ZYRTARI I AUTORIZUAR

N/KRYETARI I BASHKISË

Tajar BICI